

**Shpresa Breçani  
Audituese Ligjore  
Licence nr. 143**

**RAPORTI I AUDITUESES LIGJORE**

*Per verifikimin e procedurave te zmadhimit te kapitalit te shoqërisë*

**“I.D.K-KONSTRUKSION” shpk**

**NIPT K51408016J**

---

Adresa: Rr Jordan Misja, Pall. Sara-El, prane Hipotekes, TIRANE, Kati I, Ap I.  
Tel / fax: 04 - 2223331, Mob +355 68,20 94103 Email: [sh.brecani@yahoo.com](mailto:sh.brecani@yahoo.com), [www.shbcg.com](http://www.shbcg.com)



Drejtuar: Ortakut te vetem te Shoqerise "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk

Z. Barjam DALIPAJ

Unë, Shpresa Breçani, me profesion Audituese Ligjore me license profesionale Nr.143, date 29.06.2005 lëshuar nga IEKA, jam caktuar eksperte në misionin për verifikimin e procedurave te zmadhimit te kapitalit të shoqërisë "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, sipas Vendimin Nr.8, datë 29.06.2023 i Ortakut të vetëm të Shoqërisë "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk dhe ne zbatim te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe financiar të shoqërisë "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, jap perfundimet e mia ne raportin qe vijon:

#### **Qellimi i Anagazhimit**

Ne baze te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", te Vendimit te Ortakut te vetem te "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, Nr 8, date 29.06.2023, si dhe te pasqyrave financiare te vitit ushtrimore 2022, une, Shpresa Breçani me profesion Audituese Ligjore kam realizuar angazhimin tim per verifikimin e procedurave te kryerjes se zmadhimit te kapitalit te shoqerise ne para, nepermjet kapitalizimit te fitimet te vitit ushtrimor, ne perputhje me Standardin Nderkombetar te Dhenise se Sigurise.

Ky Standad kerkon qe une te planifikoj dhe te kryej procedurat ne menyre qe te arrij nje nivel te arsyeshme sigurie.

#### **Pergjegjesia e Drejtimi**

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen ne perputhje me kerkesat ligjore per pergatitjen dhe paraqitjen e drejtë te deklarimeve financiare, juridike dhe e informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë së procesit të hartimit te pasqyrave financiare dhe te ndryshimit te kapitalit.





Drejtimi eshte gjithashtu pergjegjes te ndermarre ne kohe te gjitha veprimet e nevojshme per realizimin e procesit te zmadhimit te kapitalit, te dorezimit te dokumentacionit prane QKR-se dhe te njoftoje palet e interesuara per procesin e zmadhimit te kapitalit me terheqjen e fitimeve te kapitalizuara.

Drejtimi ka pergjegjesine te garantoje se nuk eshte i perfshire ne ndonje proces falimentimi apo likujdimi.

### **Pergjegjesia e Auditueses Ligjore**

Pergjegjesia ime eshte te jap nje opinion mbi sigurine e procesit bazuar ne verifikimin e procedurave, te metodave te perdoruara per te arritur zmadhimit e kapitalit, si dhe pershtatshmerine e perdorimit te ketyre metodave.

### **OPINION**

Sipas Opinionit tim, pasi verifikova procedurat per zmadhimin e Kapitalit te shoqerise "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, opinionimi im per Vendimin e Ortakut te vetem eshte i drejte dhe sipas Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7923 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Audituese Ligjore  
Shpresa BREÇANI  
Nr.Lic.143.



Tirane, me 13.12.2023

### **I. BAZA LIGJORE PER KRYERJEN E KETIJ MISIONI ESHTË:**

1. Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Ligji Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR-ne".
3. Vendimi i Ortakut te vetem te Shoqerise "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk per zmadhimin e kapitailit dhe rezerves ligjore Nr.8 date 29.06.2023.
4. Bilanci i vitit ushtrimor 2022 te shoqërisë "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk.
5. Statuti dhe Akti i themelimit te shoqerise "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk.

### **II. PROCEDURAT E ANGAZHIMIT PERFSHIJNE:**

- Verifikimi i llogarive analitike si dhe kontrolli i llogarive specifike parashikuar nga Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar"; Ligji Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Verifikimi i vlerës dhe i dokumentacionit përkatës lidhur me proceduren e zmadhimit te kapitalit, bazuar ne Pasqyrat Financiare;
- Në verifikimin e dokumentacionit;
- Verifikimit të dokumentave juridikë;
- Ne evidenca të tjera të domosdoshme;
- Ne regjistrimet perfundimtare te ndryshimit te kapitalit;
- Verifikimi i Situates ekonomiko- financiare e shoqerise para momentit te zmadhimit te kapitalit.

### **III. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË.**

Shoqeria "I.D.K -KONSTRUKSION" shpk Tirane, eshte krijuar si person juridik me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane me Nr. 31854, date 05.07.2004 me kapital fillestar te nenshkruar ne vleren 100.000 leke, me vlere nominale te kuotave 1.000 leke seicila dhe me pjesmarrje aktuale ne kapital te shoqerise te Ortakut te vetem qe zoteron 100% te kuotave, Z. Barjam DALIPAJ.

Kapitali aktual i shoqerise eshte 323.000.000 lekë, teresisht ne para, i ndare ne 1 kuotë me vlere nominale 323.000.000 leke, zotëruar 100% nga ortaku i vetem z. Barjam DALIPAJ.





**Selia e shoqerise eshte ne adresen:**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK. 1 167, Vore, Tirane.

Shoqeria eshte regjistruar prane organeve tatimore Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve te Medhenje dhe pajisur me NIPT K51408016J.

**Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:**

Sinjalistike rrugore vertikale, horizontale, siguri rrugore, ndricuese dhe jondricuese, studim, projektim, prodhim, montim, tregtim dhe zbatim te tyre. Import-eksport, tregti me shumice dhe pakice te sinjalistikes rrugore, targa prokate, metale per skrap, veshjeve te punes, paisje dhe veshje per parandalimin e aksidenteve, per sigurimin teknik ne pune, vegla pune te pajisjeve dhe pjeseve industriale, telekomunikacioni, pajisje elektrike, panele diellore, etj. Tregtim artikujsh te ndryshem industriale. Tregtim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi si dhe pjese kembimi per to. Import, eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te pjeseve te kembimit per autoveturat dhe automjetet e te gjitha llojeve dhe tipeve te ndryshme duke perfshire ketu dhe makina te cdo lloji dhe tonazhi. Shitje pjese kembimi, goma te ndryshme, bateri automjetesh. Importimin dhe eksportimin e tyre. Pajisje autoservisi, pjese kembimi, goma te llojeve te ndryshme, bateri dhe lubrifikanteve te ndryshem. Riparime dhe mirmbajtje te te gjitha makinerive dhe automjeteve, sherbime mekanike, motorrike, xhenerike, elektroauto, saldimi, kovergjence, sistemi frenimit, llamarinist, bojaxhi, lavazho etj. Riparim automjetesh te ndryshme. Dhenie mjetesh me qera. Transport te mbetjeve jo te Rrezikshme. Import, eksport, prodhim, perpunim dhe tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem te plastikes, drurit, metalikes dhe nenprodukteve te tyre, te mobilerise, te pajisjeve te zyrave dhe te pajisjeve te ndryshme te spitaleve dhe institucioneve te tjera publike etj. Punime infrastrukture ne zonat e mbrojtura.

Ushtrimi i ekspertizez ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin. Hartimi i akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena. Studim dhe pergatitja e projekteve mbi masat kundra zjarrit te ndertesave te cdo lloji. Pergatitja e dokumentacioit per marrjen e aktit teknik. Trajnime e dhenie te asistences ne fushen e mbrojtjes nga zjarri. Aktivitet ne fushen e ndertimit ndertimet civile dhe industriale, rikonstruksione dhe mirembajtje civile, industriale, mirembajtje rrugore rutine dhe dimerore, ndertim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaje, metro, punime nentoksore, kanalizime, ura e vepra arti. Sherbime pastrami dhe mirembajtjeje te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, industriale dhe civile, publike dhe private, reklamave e



totemeve te ambienteve spitalore, qendrave shendetesore, qendrave tregtare, hoteleve, zyrave, universiteteve, marketeve, bankave, bar - restoranteve, porteve, aeroporteve, terminaleve, rruge etj. Tregtim (Shitje - Blerje), furnizim, importim me shumice e pakice te detergjenteve, produkteve, materialeve, pajisjeve, mjeteve, aksesoreve, makinerive te pastrimit. Sherbime dhe mirembajtje gjelberimi dhe te mjediseve te gjelberta. Veprimtari e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis, vleresim ndikimi ne mjedis (auditimi mjedisor).Transport, grumbullim dhe evadim te mbetjeve urbane, pastrim I hapësirave te qyteteve, fshatrave etj, dhe trajtimi e riciklimi I mbetjeve. Shfrytezimi i burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara. Import, Eksport, tregtim me pakice dhe shumice te bimeve medicinale, paneleve diellore, energjise elektrike etj. Ndertime dhe shfrytezime te Hidrocentraleve, Heceve, Parqeve Fotovoltaike, turbinave me ere, uje dhe impianteve te prodhimit te energjise elektrike. Punime restaurimi, restaurim i ndertesave. Punime sherbimi, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe - pyll...etj. Zhvillim Agroturizimi, Hoteleri, Turizem, pemtari etj. Rrjete inxhinierike per ujesjellesa, gazsjellesa linja tensioni te larte e te ulet, telefoni, ndricim, punime te inxhinierise se mjedisit etj. Prodhim tregtim te asfaltobetonit, betonit, inerte, material ndertimi, parafabrikat e betoni..etj. Prodhimi, tregtimi I farave, fidaneve etj, Sherbime profesionale per zbatim dhe projektim lidhur me pyje, kullota, gjelberime. Nxjerrja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda dhe jashte vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara

#### **Drejtimi i shoqerise.**

Shoqeria ka nje administrator te vetem Z. Gramoz Dalipi.

#### **IV. SITUATA EKONOMIKO - FINANCIARE E SHOQERISE para momentit te zmadhimit te kapitalit aksionar dhe te rezerves ligjore.**

Gjendja e **Kapitaleve**, te shoqerise "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, te pasqyruara ne pasqyrat financiare te vitit 2022 eshte 410.885.724 leke.

Nga verifikimet e kryera nga ana ime ne dokumentacionin kontabël, rezulton se kapitalet e shoqërisë janë te pasqyruara ne pasqyra financiare sipas dispozitave ligjore sipas përcaktimit ne nenin 117 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Pasqyrat financiare 2022 te audituara paraqiten si me poshte:





[Raport per vleresimin e procedurave te zmadhimit te Kapitalit  
per Shoqerine "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk]

	Periudha 2022	Periudha 2021
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
<b>Mjete monetare</b>	300,613,570	153,378,519
<b>Investime</b>		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>pjesmarrese</i>		
<i>aksione te veta</i>		
<i>Te tjera financiare</i>		
<b>Te drejta te arketueshme</b>		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	487,554,502	690,232,501
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>	2,565,500	3,176,600
<i>Te tjera</i>		79,216
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>		
<b>Inventaret</b>		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	79,033,156	57,802,865
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>		
<i>Produkte te gatshme</i>		
<i>Mallra</i>	13,902,715	5,530,754
<i>Aktive biologjike (gje e gjalle ne rritje dhe majmeri)</i>		
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>		
<i>Parapagime per inventar</i>	24,888,626	83,019,691
<b>Shpenzime te shtyra</b>	24,839,774	12,068,500
<b>Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara</b>		
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>933,397,843</b>	<b>1,005,288,646</b>
<b>Aktive afatgjate</b>		
<b>Aktive financiare</b>		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	50,000	
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit *</i>	5,109,470	
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate</i>		
<i>Tituj te tjere te huadhenies</i>	129,609,166	126,753,416
<b>Aktive materiale</b>		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	48,077,391	50,552,156
<i>Impiante dhe makineri</i>	55,308,500	60,432,624
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	2,642,098	2,555,351
<i>Mjete dhe pajisje Informatike</i>	2,529,705	3,077,898
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>		
<b>Aktivitet biologjike</b>		
<b>Aktive jo materiale</b>		
<i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i>	3,339,527	3,667,380
<i>Enri i mire</i>		
<i>Parapagime per AAJM</i>		
<b>Aktivitet tatimore te shtyra</b>		
<b>Totali i aktiveve afatgjate</b>	<b>246,665,857</b>	<b>247,038,825</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>1,180,063,700</b>	<b>1,252,327,471</b>



[Raport per vleresimin e procedurave te zmadhimit te Kapitalit per Shoqerine "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk]

<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	18,960,890	32,176,321
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	521,071,163	620,194,686
<i>Deftesa te pagueshme</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	14,776,268	9,746,085
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	4,072,329	4,740,381
<i>Te tjera te pagueshme</i>	295,354	
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>		
<b>Te ardhura te shtyra</b>		
<b>Provizione</b>		
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>559,176,004</b>	<b>666,857,473</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	66,889,997	81,889,997
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	38,818,056	38,818,056
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>		
<i>Deftesa te pagueshme</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te tjera te pagueshme</i>	104,121,487	114,795,487
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>		
<b>Te ardhura te shtyra</b>		
<b>Provizione</b>		
<i>Provizione per pensione</i>		
<i>Provizione te tjera</i>	172,431	172,431
<b>Detyrime tatimore te shtyra</b>		
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>210,001,971</b>	<b>235,675,971</b>
<b>Detyrime totale</b>	<b>769,177,975</b>	<b>902,533,444</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>		
<b>Kapitali i nenshkruar</b>	<b>323,000,000</b>	<b>265,000,000</b>
<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>		
<b>Rezerva rivleresimi</b>		
<b>Rezerva te tjera</b>		
<i>Rezerva ligjore</i>	21,794,027	18,191,711
<i>Rezerva statutore</i>		
<i>Rezerva te tjera</i>		
<i>Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		
<b>Fitimi/(humbja) e pashpe rrdare</b>		
<b>Fitimi/(humbja) e periudhes</b>	66,091,697	66,602,316
<b>Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike</b>	<b>410,885,724</b>	<b>349,794,027</b>
<b>Interesa jo-kontrollues</b>		
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>410,885,724</b>	<b>349,794,027</b>
<b>TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>1,180,063,700</b>	<b>1,252,327,471</b>



[Raport per vleresimin e procedurave te zmadhimit te Kapitalit per Shoqerine "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk]

Pasqyra e Performances (sipas natyres)	Periudha 2022	Periudha 2021
<b>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</b>		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	1,243,446,092	1,210,336,087
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1</i>	3,970,808	19,667
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2</i>		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3</i>		
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	992,123	7,625,541
<b>Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces</b>		
<b>Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar</b>		
<b>Te ardhura te tjera te shfrytezimit</b>		
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	(984,093,025)	(974,336,357)
<i>Te tjera shpenzime</i>		(13,311,154)
<b>Shpenzime te personelit</b>		
<i>Paga dhe shperblime</i>	(67,798,651)	(58,457,074)
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore</i>	(10,427,192)	(9,540,152)
<i>Shpenzimet per pensionet</i>		
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>	(84,855)	(936,834)
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	(16,839,093)	(18,062,064)
<b>Shpenzime te tjera shfrytezimi</b>	(74,495,818)	(58,860,164)
<b>Te ardhura te tjera</b>		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike brenda grupit, pjese e aktiveve afatgjata *</i>		
<i>Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata</i>		
<i>Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga</i>		
<i>Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga</i>		122,320
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra</b>		
<b>Shpenzime financiare</b>		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	2,102,187	(174,897)
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	(1,116,922)	(727,146)
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet</b>		
<b>Te tjera (humbje nga kembimi valutore)</b>	(17,523,914)	(4,834,545)
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	78,131,740	78,663,228
<b>Tatimi mbi fitimin</b>		
<i>Tatimi mbi fitimin e pertudhes</i>	(12,040,043)	(12,060,912)
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>		
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>		
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)</b>	66,091,697	66,602,316
<b>Te ardhura te tjera gjitheperfshtese per periudhen/vitin:</b>		
<i>Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		
<i>Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje</i>		
<i>Pjesa e te ardhurave gjitheperfshtese nga pjesmarrjet</i>		
<i>Te tjera (pershkruaj)</i>		
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshtese per periudhen/vitin (B)</b>	0	0
<b>Totali i te ardhurave gjitheperfshtese per periudhen/vitin (A+B)</b>	66,091,697	66,602,316
<b>Totali i te ardhurave gjitheperfshtese per :</b>		
Pronaret e njesise ekonomike meme		
Interesat jo-kontrollues		



Me Vendim te ortakut nr.8, date 29.06.2023 eshte vendosur zmadhimi i kapitalit dhe i rezerves ligjore, si me poshte:

*Fitimi pas Tatimit i vitit 2022 ne shumen 66.091.697 leke do te shperndalet:*

- a. Shtimi i rezerves ligjore ne shumen 5.479.100 leke;*
- b. Zmadhimit e kapitalit ne shumen 32.000.000 leke;*
- c. Rezerves te tjera per mbulimin e humbjes se aktivitetit ne Degen ne Kosove ne shumen 460.424 leke;*
- d. Shperndarje fitimi ne shumen 28.152.174 leke. Tatimi mbi dividend eshte 2.252.174 leke. Shperndarje e dividendit neto pas tatimit 25.900.000 leke.*

Me Vendim nr.11, date 04.12.2023 jam caktuar si eksperte në hartimin e raportit për vleresimin e zmadhimit te kapitalit me fitimet e vitit 2022.

#### IV-2. KAPITALI AKSIONAR PAS RRRITJES.

Zmadhimi i kapitalit është parashikuar te realizohet nëpërmjet kalimit ne kapital te fitimeve te vitit 2022.

Ne përshtatje dhe përputhje me Ligjin Nr. 129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqerite tregtare", neni 8 "Kapitali i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ndahet ne nje numer kuotash, ne raport me kontributin dhene nga cdo ortak ne shoqeri. Cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri; behen ndryshimet perkatese.

Duke qene se Zmadhimi i kapitalit realizohet nepermjet kapitalizimit te fitimit te vitit 2022, kuota mbetet nje, por vlere nominale e saj ndryshon dhe zoterimi i ortakut te vetem mbetet i pandryshuar.

Gjendja e kapitalit perpara zmadhimit paraqitet ne vlere 410.885.724 leke:

Kapitali i regjistruar.....	323.000.000 leke
Rezerva Ligjore.....	21.794.027 leke
Fitimi i vitit.....	66.091.697 leke



Gjendja e **Kapitalit Aksionar**, pas zmadhimit, paraqiten ne shumën **355.000.000 leke**, e perbere nga **1 kuote**, me vlere 355.000.000 leke, e zotëruara nga ortaku i vetem Z. Barjam Dalipaj.

PASQYRAT E KAPITALIT PAS NDRYSHIMIT TE KAPITALIT AKSIONAR

<b>Kapitali</b>	<b>Pas zmadhimit</b>	<b>Para zmadhimit</b>
Aksionet e pakices (perdoret vetem per PF te konsoliduara)		
Kapitali qe i perket aksionereve te shoqerise meme (perdoret vetem ne PF te konsoliduara)		
Kapitali aksionar	<b>355,000,000</b>	<b>323,000,000</b>
Primi i aksionit		
Njesite ose aksionet e thesarit (negative)		
Rezerva statusore		
Rezerva ligjore	<b>27,273,127</b>	<b>21,794,027</b>
Rezerva te tjera	<b>460,424</b>	
Fitimet e pashperndara		
Fitimi (humbja) e vitit financiar		<b>66,091,697</b>
<b>Totali I Kapitali</b>	<b>382,733,551</b>	<b>410,885,724</b>

Ne këto kushte Aktivi i Bilancit te shoqërisë ngelet i pa ndryshueshëm, ndërsa ne Pasqyren e kapitaleve te shoqerise për vitin 2023 do te pasqyrohen ndryshimet përkatëse si me sipër, brenda grupit te **Kapitalit**.





## V. KONKLUZIONE PERFUNDIMTARE

Ne përmbushje te misionit tim si Audituese Ligjore, caktuar nga ortaku i vetem i shoqërisë "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, për përgatitjen e Raportit për verifikimin e procedurave të zmadhimit te Kapitalit të shoqërisë jap opinion tim si vijon:

1. Vendimi i ortakut te vetëm te shoqërisë është i drejte dhe i bazuar ne ligj.
2. Kapitalit i shoqërisë "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk, nga 323.000.000 leke, pas zmadhimit shkon ne 355.000.000 leke, i ndare ne 1 kuote, me vlere 355.000.000 leke, e zotëruar nga ortaku i vetem Z. Barjam Dalipaj.
3. Zmadhimi i kapitalit realizohet nëpërmjet kalimit ne kapital fitimet e vitit 2022.

*Perfundimisht, mbi bazën e analizave te mësipërme, opinioni im per vendimin e ortakut te vetem per zmadhimit e Kapitalit se shoqerise "I.D.K-KONSTRUKSION" shpk është sipas Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7923 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".*

Raporti i paraqitur prej meje mund te miratohet nga ana e shoqerise dhe te kalohet per kryerjen e veprimeve te metejshme ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shpresa BREÇANI  
Audituese Ligjore  
Nr.Lic.143.



Tirane, me 13.12.2023